

AKT THEMELIMI & STATUTI
i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“UPTECH SALESFORCE SHPK”

Sot, më datë 07/04/2022, ortakët e shoqërisë në themelim e sipër **“UPTECH SALESFORCE SHPK”**

- **UpTech SHPK**, e regjistruar, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M02422010H, me adresë në: Rruga “Komuna e Parisit” Kompleksi Kika 2, Tirane, Shqipëri, me administrator Z. Mirgen Hoxha, lindur më 28.08.1987, në Gramsh, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: I70828003B përfaqësuar me Prokurë Nr.Rep.192, Nr.Kol.49, date 24.02.2022 nga Znj. Imelda Seferi, lindur më 10.02.1988, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: I85210065D.
- **Z. Drini Plaku**, lindur më 28.07.1993, në Durrës, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: J30728080W, me banim në adresën: Rruga Enver Zazani Nr.119, Durrës.

Bazuar në legjislacionin në fuqi vecanërisht, basuar në nenet 68 e vijues të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” LIGJI Nr. 131/2015 PËR QËNDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, në dispozitat e Kodit Civil në cilësinë e ortakeve themelues si dhe në vullnetin tonë të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizura (më poshtë shoqëria):

KREU I

Neni 1

Themelimi-Emertimi

1. Sot në datë 07.04.2022, u themelua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“UPTECH SALESFORCE SHPK”**



DRINI PLAKO

2. Themeluesit e shoqërisë janë:

UpTech SHPK, e regjistruar, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUI): M02422010H, me adresë në: Rruga “Komuna e Parisit” Kompleksi Kika 2, Tirane, Shqipëri.

Z. Drini Plaku, lindur më 28.07.1993, në Durrës, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: J30728080W, me banim në adresën: Rruga Enver Zazani Nr.119, Durrës.

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Komuna e Parisit” Kompleksi Kika 2, Tiranë. Shoqëria me vendim të Ortakëve mund të themelojë degë, zyra dhe vënde pune në vënde të ndryshme të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

1. Veprimtari në fushën e zhvillimit të programeve kompjuterike.
2. Ushtrimi i aktivitetit brënda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin.
3. Çdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të aksionereve dhe mund të kryejë çdo lloj aktiviteti në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të përfshihet në themelimin e shoqërive të tjera me qëllime të njëjta ose të ngjashme, pavarësisht statusit të tyre ligjor dhe të marrë pjesë, të bashkëpunojë dhe përfaqësojnë biznese të tjera, çfarëdo qoftë statusi i tyre ligjor në Shqipëri ose jashtë vendit.



DRINI PLAKU

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Neni 5

Kapitali Themeltar, Kontributi, Kuotat

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është:

1. Ortaku **UpTech SHPK** zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 60,000 lekë që përbën 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku **Drini Plaku** zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 40,000 lekë që përbën 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributet e ortakëve mund të jenë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, apo të drejta).

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 6

Organet Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si më poshtë:

- a. Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emërimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe eksperteve kontabël të autorizuar



DRINI PLAKU

A handwritten signature in blue ink, which appears to read 'DRINI PLAKU', is located at the bottom right of the page.

- e. Përcaktimi i shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) e d)
 - f. Mbikqyrja e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë
 - g. Miratimi, i bilanceve
 - h. Zmadhim dhe zvogëlim kapitali
 - i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - j. Përfaqesimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve
 - k. Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë
 - l. Miraton rregulla procedurale të mbledhjeve të asamblesë
 - m. Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti
- Ortaku mund të përfaqesohet në asamblene e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblene e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 7

Mbledhja dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asembleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë, dhe vendos për çdo çështje që ka të bëjë me shoqërinë, për të cilën në përputhje me Ligjin ose këtë Statut kërkohet vendim i Asamblesë dhe ky vendim është i detyrueshëm për të gjithë.

Neni 8

Administratri dhe përfaqësimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet me të drejtë ripërteritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:



Znj. Imelda Seferi, shtetase Shqiptare. lindur më 10.02.1988, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal: I85210065D



Neni 9

Kompetencat e administratorit

Kompetencat e administratorit

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure apo autorizimi me afat të caktuar apo të pacaktuar, një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë në përputhje me kompetencat që ka në këtë statut.



DRINI PLAKU

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Drini Plaku'.

KREU IV

Neni 10

Viti Financiar

Viti financiar fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor 2022.

KREU V

Neni 11

Prishja dhe Likuidimi

Shoqëria priset:

- a) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit.
- c) me vendim gjykatë.

Mënyra të tjera të parashikuara nga ligji në fuqi

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 11

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.


Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Ky Statut nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale, me të njëjten vlerë secila.

ORTAKET E SHOQËRISE

UPTECH SH.P.K.

Imelda Seferi



Drini Plaku

DRINI PLAKU